



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr.19
Prishtinë, me 12 janar 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L
nga mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Shkumbin Demaliaj, Bojan Stojanovič Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Melihate Termkollli, Agim Veliu, Gani Geci dhe Zulfi Merxha.

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetari i komisionit

Për këtë mbledhje ishte propozuar ky rend ditë:

1. Situata aktuale e Sigurisë në Kosovë

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e vetme të rendit të ditës: **1. Situata aktuale e Sigurisë në Kosovë.**

Në fillim të këtij takimi kryetari i komisionit tha, të nderuar anëtar të komisionit kjo është mbledhja e parë e komisionit tonë për këtë vit, dhe e shihni si pikë e vetme për shqyrtim është situata e sigurisë në Kosovë. Ne si Komision në vazhdimësi kemi përcjellë situatën e sigurisë në Kosovë. Komisioni ka bërë edhe rekomandime me kërkesën që ato të dalin dhe të shqyrtohen në seancë plenare. Por ju e dini si ka ecur procedura dhe ato nuk shkuan për seancë. Ka një lidhshmëri mes incidenteve në Preshevë dhe Mitrovicë, pastaj hyrja e trenit serb në territorin e Kosovës janë provokime të qëllimshme. Në si komision jemi kapacitet i Kuvendit dhe nuk jemi organ ekzekutiv- operativ për aktivitet në terren. Por ne kemi obligim kushtetues të mbikëqyrim punën e sektorit të sigurisë dhe të bëjmë propozim- rekomandime për punën e tyre.

Prandaj ne sot këtu do të diskutojmë mënyrën si të procedojmë më tutje, a do të shkojmë me disa rekomandime për situatën e sigurisë, apo të thërrasim në komision ministrin Zenun Pajazitit. Unë e hap diskutimin lidhur me këtë çështje.

Gani Geci tha, ne e kemi ngrit zërin si komision pra kemi bërë rekomandime të cilat i kemi dërguar në kryesi por ata nuk i kanë marr parasysh. Unë kam dashur që situata e sigurisë të diskutohet para se të del nga kontrolli. Serbia po arreston pjesëtarët e UÇK-së si të akuzuar për krime lufte, ndërsa pjesëtarët serb që kanë qenë të akuzuar për krime lufte kanë ik nga burgu i Kosovës dhe ndoshta janë ata që po mundohen ta qesin jashtë kontrollit situatën dhe në këtë drejtim nuk po ndërmerret asgjë as nga UNMIK-u, as nga KFOR-i, e as nga MPB-ja, në mënyrë që të paktën të kemi fuqinë që grupet kriminale të mos kenë vend në Kosovë. Kosova ka humbje marramendëse nga këto grupe, sepse pikat kufitare janë të djegura pra nuk kontrollohen, kështu që grupet kriminale janë duke bërë atë që ata e kanë ndërmend, pra destabilizimin e Kosovës. Prandaj unë mendoj që ne duhet të kërkojmë, që situata e sigurisë të diskutohet në Parlamentin e Kosovës dhe vendimet që i merr parlamenti janë obliguese për Qeverinë e Kosovës.

Naim Maloku tha, mendoj se thirrja e një mbledhje të tillë pa pjesëmarrjen e mekanizmave që janë të lidhur direkt me çështjen e sigurisë, ne na qon te paraqitja e mendimeve tona individuale ose si subjekt politik. Unë si çdo qytetar dhe si deputet e ndaj shqetësimin për situatën e sigurisë dhe për të gjitha incidentet që kanë ndodh, por unë propozoi që ne si komision të kërkojmë raport nga MPB-ja, SHPK-ja dhe Inspektorati Policor, mbi të cilat kem kompetenca të mbikëqyrjes parlamentare. Pra paraprakisht ne duhet tu dërgojmë disa pyetje këtyre segmenteve dhe pasi ta marrim raportin, në të kërkojmë dëgjim nga MPB-ja, në lidhje me raportin dhe pastaj në raport ne si komision i qesim rekomandimet tona që i nxjerr ky komision nga ai raport.

Agim Veliu tha, ngjarjet e fundit në veri të Kosovës kanë dëshmuar se ka mungesë të rendit dhe ligjit sidomos në pjesën veriore të Mitrovicës. Pra ne si komision duhet të ndërmarrim atë që na takon, që të mos i përsëris ato që i tha z.Naim Maloku, e pastaj të konkludoj se çka është në pyetje, pra të grumbullojmë fakte dhe pastaj të nxjerrim një raport me sugjerimet tona.

Melihate Termkollit tha, fillimisht duhet të them se po mungon një veprim politik nga organet më të larta të vendit, sepse nuk po ndërmerret asgjë sa i përket sigurisë në vend. Ne e dimë që veriu nuk është problem që ka lind sot, ne e dimë që ka kohë që është një situatë e tillë, por tani ky vend ka kushtetutë dhe nuk mund të themi se kushtetuta zbatohet copa-copa, kushtetuta duhet të zbatohet në tërë territorin. Parlamenti nuk ka një strategji të Qeverisë për gjendjen e sigurisë në vend e kryesisht në veri, gjithashtu ende kemi një mungesë të kompletimit të institucioneve të sigurisë, të parapara me kushtetutë dhe mendoj se nuk ka ndonjë arsye që kjo të ndodh kështu siç po ndodh. Unë mendoj se ky komision duhet ti paraqes rekomandimet për debat në seancë dhe nëse kryesia prapë nuk i sheh të arsyeshme ti fus në rend dite për seancë, atëherë duhet të gjinden forma të tjera që gjithsesi të debatohet për situatën e sigurisë në parlament.

Zafir Berisha tha, ne tash e sa herë po e përsërisim këtë temë, ne kemi tentuar disa herë të diskutohet çështja e sigurisë por kryesia nuk e ka pa të arsyeshme. Pra unë pajtohem me mbajtjen e një dëgjimi me institucionet e sigurisë që të informohemi se çka po ndodh dhe mendoj se kjo duhet të organizohet më së shumti deri të hënën.

Shkumbin Demaliaj tha, unë mendoj se te ne në komision është harxhuar debati i mos shqyrtimit të rekomandimeve nga kryesia, ne jemi takuar edhe herë tjera për të diskutuar se pse kryesia nuk i ka qit në rend dite këto rekomandime dhe tani prapë po merremi me të njëjtën çështje. Tani kur të flitet për situatën e sigurisë në veri, ne duhet të kemi bashkëpunim edhe me ndërkombëtarët si KFOR-in, EULEX-in etj, në mënyrë që të dimë më hollësisht se çka po ndodh. Gjithashtu është bërë një praktik e keqe e Qeverisë për financimin e objekteve të shkatërruara në veri të Mitrovicës, sepse dikush mund ta ketë një objekt të vjetër dhe ta djeg vetë që pastaj ti rinovohet. Prandaj mendoj që vetëm zbatimi i ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë, neve na qon drejt qëllimeve tona.

Eqrem Kryeziu tha, është nder i këtij komisioni futja si rend dite, situata aktuale e sigurisë në Kosovë. Unë po pajtohem me atë që tha z.Naim Maloku për organizimin e një dëgjimi publik, por unë kisha propozuar që ne të kemi shembuj konkret, se si të zgjidhet situata e sigurisë dhe jo vetëm të bëjmë prezantim të situatës së sigurisë, në mënyrë që të promovohet parlamenti. Unë mendoj se prania e EULEX-it në Kosovë është premtuese, sepse UNMIK-u i ka pasur te konservuara raportet e veta, nuk ka pas interes të bëjë diçka në lidhje me atë se, a me mbet serbët gjithmonë ashtu të ndarë në veri të Mitrovicës, apo duhet të integrohen.

Bojan Stojanović tha, unë e përcjella bisedën e juaj dhe sinqerisht më ka ardhur keq për gjithçka që ka ndodhur në veri të Mitrovicës, edhe pse unë skam qenë këtu gjatë asaj kohe, mirëpo çdo dhunë prej kujt do çoftë ajo as për ne s'është e mirëseardhur. Mund t'u them se edhe shumica e njerëzve që jetojnë atje kanë qenë kundër atyre ngjarjeve, ndoshta nuk e kanë guximin ta thonë hapur por besojnë se fjala është për grupe të interesit, sepse ka njerëz që ende bëjnë tregti nëpërmes urës së Ibrit, atyre nuk ju intereson ligji dhe kujt i takojnë, ata më së miri funksionojnë në mes veti dhe atyre normal që ju konvenon vazhdimi i një situatë të tillë. Sinqerisht ju them se atje ka njerëz të ndershëm të cilët nuk dinë shumë rreth politikës, por atyre ju intereson se si ta ndërtojnë sa më mirë të ardhmen e tyre. Unë do ta përkrahi komisionin ashtu siç e kamë përkrahur edhe deri më tani dhe është mirë që gjithë së bashku këtu kemi të njëjtin mendim. Sinqerisht besoi se tani me praninë e EULEX-it shumë shpejt do të zgjidhet edhe kjo situatë.

Emrush Xhemajli tha, ne po e shohim se në shtetin tonë të ri ka nevojë që të punohet pak më shumë në relacionin komision – kryesi, pra duhet të ketë një lloj besimi në punë, sepse kthimi disa herë i rekomandimeve të nxjerra nga ky komision po e pasqyron këtë. Gjithashtu e përkrah propozimin e z.Naim Maloku dhe mendoj që kjo çështje duhet të shpejtohet pak, që pastaj rekomandimet ti procedojmë në kryesi, nëse prapë ne nuk gjejmë mbështetje atëherë si deputet mund të përdorim metoda tjera për të debatuar për sigurinë në vend, pra ne mund të bëjmë mbledhjen e nënshkrimeve të deputetëve, por unë besoi se nuk do të jetë e nevojshme të vij deri te kjo.

Zylfi Merxha tha, të gjitha ato që u than këtu sot janë të qëlluara dhe mendoj se kjo s'duhet të zgjat shumë, mendoj se krejt kjo duhet të organizohet më së largu deri të hënën.

Kryetari në përmbyllje të këtij takimi tha, ne do ti bëjmë disa pyetje për MPB-në dhe Policinë e Kosovës dhe do ti thërrasim të raportojnë para komisionit, pastaj në raport do ti qesim rekomandimet e komisionit dhe do të kërkojmë që Kryesia e Kuvendit ta lejoj debatin për situatën e sigurisë, sepse nuk është temë tabu siguria e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit